



# Albania

## Fuqia ekonomike dhe drejtuesit e të ardhmes

Në Shqipëri, ndonëse janë bërë përparime në barazinë gjinore, sërish ka diferenca të mëdha, sidomos kur bëhet krahasimi për “pushtetin” ekonomik.

Meshkujt paguhen më shumë sesa femrat dhe dominojnë në pozicionet drejtuese në biznes, ndonëse femrat kanë nivel më të lartë të arsimit universitar se pjesa më e madhe e të arsimuarve në pozicionet drejtuese të bizneseve.

Mundësimi i pjesëmarrjes së gruas në vendimarrje do të zgjerojë pjesën e popullatës aktive profesionalisht dhe të ushqejë brezin e drejtuesve të së ardhmes.

### Rol drejtues në Qeveri



- 70% e qeverisë aktuale përbëhet nga ministre gra.
- 35,7% e kuvendit përbëhet nga deputete femra



Pjesëmarrja më e madhe e grave shihet në :

- “Komisionin për punën, çështjet sociale dhe shëndetësinë” : 61,9%
- “Komisionin për edukimin dhe mjetet e informimit publik” : 57,9%.

### Rol drejtues në Biznes



- 24.1% e ndërmarrjeve në total kanë pronare ose administratore femra.
- 24,2% e ndërmarrjeve të vogla kanë pronare ose administratore femra.



- Tiranë 32.2% e totalit
  - Berat : 15.5% e totalit
- Mesatarja europiane sipas Eurostat është 35%.

### Niveli i Pagave

Burrat paguhen më mirë, por femrat në drejtim ua kalojnë.



Drejtueset administrative dhe komerciale femra paguhen mesatarisht **172 mijë lekë në muaj**.



Drejtueset administrative dhe komerciale meshkuj marrin mesatarisht **154 mijë lekë në muaj**.

## Drejtuesit e të ardhmes :

Meshkujt paguhen më shumë, por femrat janë më të shkolluara me arsim të lartë  
Në vitin akademik 2020-2021 numri i të diplomuarëve femra tejkalon atë të meshkujve:



Numri i të diplomuarëve në arsimin e lartë në vitin akademik 2020-2021 ishte afërsisht **33 mijë studentë ndër të cilët femrat përbënin 66,1%**.

Femrat janë më të orientuara drejt studimit për role drejtuese:

- Në “Administrim biznesi dhe ligje”, 30.2% e të diplomuarave ishin femra përkundrajt 29.7% meshkuj.
- Në “Shëndet dhe mirëqenie” 18.3% të totalit të diplomuarave ishin femra.
- Në “Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim”, 18.9% të totalit të diplomuarave ishin meshkuj.

## Fuqia ekonomike :



Femrat janë më të shkolluara me arsim të lartë

Burrat paguhen më shumë dhe pushteti ekonomik është tek burrat.



- Në 3.5 milionë llogari depozituese në sektorin familjar, 57% mbahen nga burrat.
- Burrat mbajnë më shumë përgjegjësi dhe në marrjen e një kredie. Nga rreth 400 mijë hua që janë marrë nga familjarët, 57% kanë qenë në emër të burrave.

## Ripërtëritja e popullatës dhe potenciali drejtues



- Gratë jetojnë më gjatë
- Moshë mesatare e grave në Shqipëri është më e lartë se burrave, 39,1 vjet.
- Gratë punojnë mesatarisht 45 orë në javë.



- Moshë mesatare e burrave në Shqipëri është më e ulët se e grave, 37,3 vjet.
- Burrat punojnë mesatarisht 50 orë në javë.